



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI

VENDIM

Nr 30 date 30.04.2026

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË BASHKISË PËR FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE PËR MUAJIN PRILL 01-30.04.2026.

Në bazë të Ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, vendimit Nr 85 datë 10.02.2021, si dhe bazuar në Udhëzimi nr.4 datë 17.02.2017 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pika 7, Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligjit 68/2017 “Mbi Financat e Vetëqeverisjes Vendore” VKB nr. 101 datë, 22.12.2025 për “Për Miratimin Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026” është miratuar fond “Ndihma Ekonomike” me fond limit 3.000.000 lekë/vit, Këshilli i Bashkisë Gjirokastrë;

VENDOSI:

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **Prill 2026, 49 individë/ familje me fond 141,193 lekë.**
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Agjencia e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, (Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Shoqërore), si dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I KËSHILLIT
Bexhet BAXHELLA

KRYETARI I KËSHILLIT
Merita ISARAJ

